

VENDIM
Nr.201, datë 21.2.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA GRADISHTË TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Gradishtë të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 6 (gjashtë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gradishtë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2.FORMULARI PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Mbeshtetur ne inventarizimin e pronave te vecanta te tipit Kullota , Livadhe , Shkembore etj)

<i>Institucioni i Pushtetit Qendror Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujterave.</i> <i>Komuna: Gradishtë</i>										
Nr	Nr. i INV Sipas VKM	Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe kullosore (EPK)	Emertesa e Ngastres Vendendodhja (sipas emerteses popullore)	Numri i ngastres	Destinacioni	Siperfaqe Ne ha	Funksioni Per te cilin Perdoret prona	Institucioni Enti me Pergjegjesit Administrative	Institucioni Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te Vecanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	115	Gradisht- Gjeneruk	Kodra ullinjeve	31/a	pyll	5.2	Prodhues	M.M.P.A.U	D.SH.P Lushnje	
2	116	Gradisht- Gjeneruk	Perroi qorres	32/a	Pyll	43	Prodhues	M.M.P.A.U	D.SH.P Lushnje	
3	117	Gradisht- Gjeneruk	Faga e lajthis	33/a	Pyll	45.9	Prodhues	M.M.P.A.U	D.SH.P Lushnje	
4	124	Gradisht- Gjeneruk	Gropa e kallmit	40/a	pyll	45.9	Prodhues	M.M.P.A.U	D.SH.P Lushnje	
5	125	Gradisht- Gjeneruk	Gropa e kallmit	40/b	pyll	5.5	Prodhues	M.M.P.A.U	D.SH.P Lushnje	
6	126	Gradisht- Gjeneruk	Gropa e kallmit	40/c	boshe	1.5		M.M.P.A.U	D.SH.P Lushnje	

Lidhja 1

[illegible]